



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**RREGULLORE**

**MBI**  
**PËRMBAJTJEN, AFATET KOHORE DHE FORMËN E RAPORTEVE TË**  
**SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, SHOQËRIVE**  
**ADMINISTRUESE DHE DEPOZITARËVE**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 107, datë 30.06.2021*

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat lidhur me përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raportimit të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Shoqërive Administruese dhe Depozitarëve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (këtu e më poshtë “Autoriteti”), në lidhje me:

- a. Aktivitetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK), shoqërive të administrimit dhe depozitarëve. Raportet e detyrueshme për aktivitetin, të dorëzuara pranë Autoritetit, do të jenë raporte të mbikëqyrjes dhe raporte statistikore. (Shtojcat 1, 2, 3, 8);
- b. Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese brenda vitit ushtrimor, me anë të të cilave shoqëritë e administrimit informojnë Autoritetin dhe përdoruesit e tjerë të jashtëm në lidhje me gjendjen e tyre financiare, rezultatet e aktivitetit dhe rrjedhjen e parave. (Shtojca 4);
- c. Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese brenda vitit ushtrimor të fondeve të investimit, hartuar me qëllim informimin e Autoritetit dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm rreth gjendjes së tyre financiare, rezultateve financiare për

- rezultatet e aktivitetit dhe rrjedhjes së parave. (Shtojca 5);
- d. Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese brenda vitit ushtrimor të shoqërive të investimit, hartuar me qëllim informimin e Autoritetit dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm rreth gjendjes së tyre financiare, rezultateve financiare për rezultatet e aktivitetit dhe rrjedhjes së parave. (Shtojca 6);
  - e. Raporte të mbikëqyrjes së likuiditetit për SIK me ofertë publike. (Shtojca 7).

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 48, 137, 200 dhe pikës 6 të nenit 203 të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e investimeve Kolektive”

## **Neni 3**

### **Përkufizimet**

1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në Ligjin Nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
2. “Ligji” është Ligji nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

## **KREU II**

# **RAPORTET STATISTIKORE DHE TË MBIKËQYRJES TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, SHOQËRIVE TË ADMINISTRIMIT DHE TË DEPOZITARËVE**

## **Neni 4**

### **Raportet e mbikëqyrjes**

1. Raportet e mbikëqyrjes do të jenë:
  - a. Për fondet e investimit:
    - i. Pasqyrat financiare të fondit të investimit;
    - ii. Raportet shoqëruese për pasqyrat financiare të fondit të investimit.
  - b. Për depozitarët:
    - i. Raport mbi asetet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive për të cilat depozitari ofron shërbime depozitari;
    - ii. Raport mbi saktësinë e metodave dhe rezultateve të vlerësimit të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive për të cilat depozitari ofron shërbime depozitari;
    - iii. Raport mbi devijimin nga struktura e synuar e investimeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive për të cilat depozitari ofron

- shërbime depozitari;
- iv. Raport mbi investimet e sipërmarrjes së investimeve kolektive.
2. Struktura dhe përmbajtja e raporteve të mbikëqyrjes të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë të përshkruara në formatet që janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje, përkatësisht:
- Raportet mbi aktivitetin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (Shtojca 1);
  - Raport mbi strukturën e kuotambajtësve/aksionarëve (Shtojca 2); si dhe
  - Raportet mbi aktivitetin e depozitarëve (Shtojca 3).

## **Neni 5**

### **Raportet mbi vlerësimin e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive**

- Raportet mbi vlerësimin e aseteve të sipërmarrjes dhe llogaritja e vlerës neto të aseteve për kuotë/aksion do të përgatitet nga depozitari për sipërmarrjet e investimeve kolektive, për të cilat ai ofron shërbime depozitari dhe do të dërgohet tek Autoriteti në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim, brenda orarit zyrtar të ditës së vlerësimit. Të dhënat ditore të muajit paraardhës do të dërgohen në Autoritet në formë shkresore brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës.
- Raportet mbi mbajtësit e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, raportet që shoqërojnë pasqyrat financiare të sipërmarrjes së investimeve kolektive, si dhe raportet mbi kapitalin fillestar dhe ruajtjen e kapitalit të shoqërive të administrimit, do të përgatiten nga shoqëritë e administrimit dhe do të dorëzohen tek Autoriteti brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore për secilin lloj të sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe shoqërisë së administrimit.
- Raportet e mbikëqyrjes të referuara në nenin 4, paragrafi 1, pika (b) shkronja i), ii) dhe iii) të kësaj rregulloreje, përgatiten nga depozitari brenda një afati të njëjtë me afatin e për vlerësimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve për të cilat ai ofron shërbime depozitari dhe dorëzohen në Autoritet pa vonesë, në rastet e përmendura në pikën 12 të nenit 137 të Ligjit, si dhe me kërkesë të Autoritetit.
- Raportet mbi investimet e sipërmarrjes së investimeve kolektive duhet të raportohen nga depozitari në Autoritet, në formë shkresore si dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim, brenda afateve të përcaktuara për raportimin e pasqyrave financiare nga ana e shoqërive administruese, të referuara në nenin 11, paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 6**

### **Raportet statistikore**

- Raportet statistikore do të jenë raportet mbi aktivitetin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të shoqërive të administrimit dhe depozitarëve, dhe përmbajtja e tyre, forma dhe

afatet e dorëzimit do të përcaktohen nga Autoriteti, në varësi të qëllimit të kërkimit/analizës së sistemit të shërbimeve financiare jo-bankare, të raportimit për publikun dhe përdoruesve të shërbimeve të lidhura, si dhe shkëmbimit të informacioneve me organet e tjera mbikëqyrëse dhe/ ose institucionet e autorizuara për statistika ose mbikëqyrje publike.

2. Si përjashtim i paragrafit 1 të këtij neni, Autoriteti, pa cenuar parimet e autorizimit, konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave, mund të pranojë pyetësorë statistikorë/metoda të mbledhjes së të dhënave, të përcaktuara nga organet e tjera mbikëqyrëse dhe/ose institucionet e autorizuara për statistika ose mbikëqyrje publike.

## **Neni 7**

### **Udhëzimet teknike**

Raportet e përmendura në nenet 4 dhe 6 të kësaj rregulloreje, duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në Autoritet nga shoqëritë e administrimit dhe depozitarët, në ato mënyra siç përshkruhen në këtë rregullore.

## **KREU III**

### **PASQYRAT FINANCIARE DHE SKEMA E LLOGARIVE KONTABËL TË SHOQËRIVE ADMINISTRUESE**

## **Neni 8**

### **Regjistrimet kontabël dhe përgatitja e pasqyrave financiare**

Shoqëritë administruese duhet të mbajnë libra kontabël, të hartojnë dhe publikojnë pasqyra financiare në përputhje me ligjin “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe me dispozitat ligjore që rregullojnë kontabilitetin dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.

## **Neni 9**

### **Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare**

1. Pasqyrat vjetore financiare të shoqërive administruese duhet të përfshijnë:
  - a. Pasqyrën e Bilancit;
  - b. Pasqyrën e Fitim / Humbje;
  - c. Pasqyrën e Fluksit të Parave;
  - d. Pasqyrën e Lëvizjeve të Kapitalit, si dhe;
  - e. Shënimet e pasqyrave financiare.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të shoqërive administruese është përcaktuar nga format në Shtojcën 4, të cilat janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

3. Shoqëritë administruese duhet të hartojnë pasqyrën e rrjedhjes së parave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duke përdorur mënyrën e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë.

### **Neni 10**

#### **Periudhat e raportimit dhe llojet e pasqyrave financiare**

1. Pasqyrat financiare do të përpilohen për vitin ushtrimor për gjendjen në 31 dhjetor dhe për nënperiudha gjatë vitit ushtrimor për gjendjen më 31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator të vitit aktual.
2. Pasqyrat financiare të referuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përpilohen dhe të dorëzohen në forma me përmbajtje dhe formë të njëjtë me raportet financiare të referuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.
3. Si përjashtim i paragrafit 2 të këtij neni, shënimet e pasqyrave financiare për periudhat gjatë vitit, duhet të paraqesin vetëm ngjarjet e rëndësishme të aktivitetit dhe ndryshimet në politikat kontabël, në lidhje me pasqyrat më të fundit financiare vjetore të publikuara.

### **Neni 11**

#### **Afatet për dorëzim**

1. Shoqëritë e administrimit duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore të audituara deri më 30 prill të vitit pasardhës.
2. Shoqëritë e administrimit duhet të paraqesin pasqyrat financiare vjetore të paaudituar deri më 15 janar të vitit pasardhës.
3. Shoqëritë e administrimit duhet të paraqesin pasqyrat financiare për periudhat raportuese gjatë vitit si vijon:
  - a. Për periudhën tremujore me gjendjen e periudhës deri më 31 mars të vitit aktual, deri më 15 prill të vitit aktual;
  - b. Për periudhën gjashtëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 qershor të vitit aktual, deri më 15 korrik të vitit aktual;
  - c. Për periudhën nëntëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 shtator të vitit aktual, deri më 15 tetor të vitit aktual.

### **Neni 12**

#### **Mënyra e dorëzimit**

1. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në

formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim brenda afateve të referuara në nenin 11, paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.

2. Shoqëritë administruese duhet të depozitojnë me shkrim në Autoritet, brenda afatit të referuar në nenin 11, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:
  - a. Pasqyrat e audituara financiare vjetore të shoqërisë së administrimit, si dhe
  - b. Raportin nga shoqëria audituese për auditimin e pasqyrave financiare vjetore.
3. Shoqëritë administruese duhet të depozitojnë me shkrim në Autoritet, brenda muajit qershor të vitit pasardhës Raportin vjetor.
4. Në rast se nga raporti i auditimit rezulton se të dhënat ndryshojnë nga ato të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të paaudituar, të dorëzuara brenda afatit të përmendur në nenin 11, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, shoqëria administruese do të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore me ndryshimet e pësuara nga raporti i auditimit brenda afatit të referuar në nenin 11, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje.

### **Neni 13**

#### **Publikimi i pasqyrave financiare**

Shoqëritë administruese do të publikojnë pasqyrat vjetore financiare të audituara në faqen e saj të internetit, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asambleja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik në përputhje me rregullat për kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve të Raportimit Financiar.

## **KREU IV**

### **PASQYRAT FINANCIARE DHE SKEMA E LLOGARIVE KONTABËL TË FONDEVE TË INVESTIMEVE**

### **Neni 14**

#### **Përmbajtja e pasqyrave financiare**

1. Pasqyrat financiare të fondeve të investimit do të përfshijnë:
  - a. Pasqyrën e Pozicionit Financiar;
  - b. Pasqyrën e Fitim/Humbjeve;
  - c. Pasqyrën e Fluksit së Parave;
  - d. Pasqyrën e ndryshimeve në vlerën neto të aseteve;
  - e. Pasqyrën e treguesve të veçantë të fondit;
  - f. Shënimet e pasqyrave financiare.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të referuara në paragrafin 1 të këtij

neni përshkruar në format në Shtojcën 5, të cilat janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

3. Si përjashtim i paragrafit 2 të këtij neni, shënimet në pasqyrat financiare për periudhat gjatë vitit ushtrimor duhet të paraqesin vetëm ngjarjet e rëndësishme të aktivitetit dhe ndryshimet në politikat kontabël në lidhje me pasqyrat më të fundit financiare vjetore të publikuara.
4. Për përgatitjen e pasqyrës së fluksit së parave të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të përdoret metoda jo e drejtpërdrejtë.

## **Neni 15**

### **Hartuesi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare të referuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje, do të hartohen nga shoqëritë administruese për fondet e investimit nën administrimin e tyre.

## **Neni 16**

### **Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare**

1. Shoqëritë administruese duhet të mbajnë libra kontabël dhe të hartojnë e publikojnë pasqyrat financiare për fondet e investimit që administrojnë në përputhje me Ligjin “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe me dispozitat që rregullojnë kontabilitetin dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.
2. Pasqyrat vjetore financiare të fondeve të investimit do të auditohen nga ekspertë kontabël të certifikuar.

## **Neni 17**

### **Afatet për dorëzim**

1. Pasqyrat financiare do të përpilohen për vitin ushtrimor për gjendjen në 31 dhjetor dhe për nënperiudha gjatë vitit ushtrimor për gjendjen më 31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator të vitit aktual.
2. Afatet për dorëzimin e pasqyrave financiare për periudhat raportuese gjatë vitit të aktivitetit do të jenë si vijon:
  - a. Për periudhën tremujore me gjendjen e periudhës deri më 31 mars të vitit aktual, deri më 15 prill të vitit aktual;
  - b. Për periudhën gjashtëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 qershor të vitit aktual, deri më 15 korrik të vitit aktual;
  - c. Për periudhën nëntëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 shtator të vitit aktual,

më 15 tetor të vitit aktual.

3. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të paaudituar me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 15 janari i vitit pasardhës.
4. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të audituar me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 prilli i vitit pasardhës.
5. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave të konsoliduara financiare vjetore me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 qershor i vitit pasardhës.
6. Afati i dorëzimit të shtojcës Nr. 2 me të dhëna statistikore është i njëjtë me ato të Pasqyrave Financiare.

### **Neni 18**

#### **Mënyra e dorëzimit**

1. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim brenda afateve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 17 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëritë administruese duhet të depozitojnë me shkrim në Autoritet, për fondet e investimit, brenda afatit të referuar në nenin 17, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:
  - a. Pasqyrat e audituara financiare vjetore të fondit, si dhe
  - b. Raportin nga eksperti kontabël i pavarur për auditimin e pasqyrave financiare vjetore.
3. Në rast se nga raporti i auditimit rezulton se të dhënat ndryshojnë nga ato të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të paaudituar, të dorëzuara brenda afatit të përmendur në paragrafin 3 të nenit 17, shoqëritë administruese, për fondet e investimit, do të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore me ndryshimet e pësuar nga raporti i auditimit brenda afatit të referuar, në nenin 17, paragrafi 4 i kësaj rregulloreje.
4. Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëritë administruese duhet të dorëzojnë pranë Autoritetit pasqyrat e konsoliduara financiare vjetore të audituara, raportin nga një ekspert kontabël i certifikuar në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare vjetore të fondeve të investimeve dhe raportin vjetor, vetëm me shkrim.
5. Mënyra e dorëzimit të shtojcës Nr. 2 me të dhëna statistikore është i njëjtte me atë të Pasqyrave Financiare.



**Neni 19**  
**Publikimi i pasqyrave financiare**

1. Shoqëritë administruese do të publikojnë pasqyrat vjetore financiare të audituara dhe pasqyrat vjetore financiare të konsoliduara të fondit të investimit në faqen e saj të internetit, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asambleja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik në përputhje me rregullat për kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve të Raportimit Financiar.
2. Shoqëritë e administrimit do të publikojnë, për fondet e investimit, pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare për periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor në faqen e tyre të internetit, brenda afateve të përmendura në nenin 17 të kësaj rregulloreje.

**KREU V**  
**PASQYRAT FINANCIARE DHE SKEMA E LLOGARIVE KONTABËL TË SHOQËRIVE TË**  
**INVESTIMEVE**

**Neni 20**  
**Përmbajtja e pasqyrave financiare**

1. Pasqyrat financiare të shoqërive të investimeve do të përfshijnë:
  - a. Pasqyrën e Bilancit;
  - b. Pasqyrën e Fitim/Humbje;
  - c. Pasqyrën e Fluksit të Parave;
  - d. Pasqyrën e ndryshimit të kapitalit;
  - e. Pasqyrën e treguesve të veçantë të shoqërisë së investimit;
  - f. Shënimet e pasqyrave financiare.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë përshkruar nga format në shtojcën 6, të cilat janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
3. Si përjashtim i paragrafit 2 të këtij neni, shënimet e pasqyrave financiare për periudhat gjatë vitit ushtrimor duhet të paraqesin vetëm ngjarjet e rëndësishme të biznesit dhe ndryshimet në politikat kontabël në lidhje me pasqyrat më të fundit financiare vjetore të publikuara.
4. Për përgatitjen e pasqyrës së fluksit të parave të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të përdoret metoda e drejtpërdrejtë.

**Neni 21**  
**Dorëzuesi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare të referuara në nenin 20 të kësaj rregulloreje, do të dorëzohen në Autoritet

nga shoqëria e investimit, në përputhje me propozimin e paraqitur tek ajo nga shoqëria administruese.

## **Neni 22**

### **Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare**

1. Shoqëritë e investimit duhet të mbajnë libra kontabël, të hartojnë dhe publikojnë pasqyrat financiare në përputhje me Ligjin “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe me dispozitat që rregullojnë kontabilitetin dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.
2. Pasqyrat vjetore financiare të fondeve të shoqërive të investimeve do të auditohen nga ekspertë kontabël të certifikuar.

## **Neni 23**

### **Afatet për dorëzim**

1. Pasqyrat financiare do të përpilohen për vitin ushtrimor për gjendjen në 31 dhjetor dhe për nënperiudha gjatë vitit ushtrimor për gjendjen më 31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator të vitit aktual.
2. Afatet për dorëzimin e pasqyrave financiare për periudhat raportuese gjatë vitit të biznesit do të jenë si vijon:
  - a. Për periudhën tremujore me gjendjen e periudhës deri më 31 mars të vitit aktual, deri më 15 prill të vitit aktual;
  - b. Për periudhën gjashtëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 qershor të vitit aktual, deri më 15 korrik të vitit aktual;
  - c. Për periudhën nëntëmujore me gjendjen e periudhës deri më 30 shtator të vitit aktual, më 15 tetor të vitit aktual.
3. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të paaudituar me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 15 janari i vitit pasardhës.
4. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të audituar me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 prilli i vitit pasardhës.
5. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave të konsoliduara financiare vjetore me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 qershor i vitit pasardhës.

## **Neni 24**

### **Mënyra e dorëzimit**

1. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë

qëllim brenda afateve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 23 të kësaj rregulloreje.

2. Shoqëria e investimit duhet të depozitojë me shkrim në Autoritet, brenda afatit të referuar në nenin 23, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, si më poshtë:
  - a. Pasqyrat e audituara financiare vjetore të shoqërisë së investimit;
  - b. Raportin nga eksperti kontabël i pavarur për auditimin e pasqyrave financiare vjetore, si dhe;
  - c. Raportin vjetor.
3. Shoqëritë e investimit duhet të depozitojnë me shkrim në Autoritet, brenda muajit qershor të vitit pasardhës Raportin vjetor.
4. Në rast se nga raporti i auditimit rezulton se të dhënat ndryshojnë nga ato të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të paaudituar, të dorëzuara brenda afatit të referuar në nenin 23, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e investimit do të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore me ndryshimet e pësuara nga raporti i auditimit brenda afatit të referuar në nenin 23, paragrafi 4 i kësaj rregulloreje.
5. Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëritë e investimit duhet të dorëzojnë pranë Autoritetit pasqyrat e konsoliduara financiare vjetore të audituara, raportin nga një ekspert kontabël i certifikuar në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportin vjetor, vetëm me shkrim.

## **Neni 25**

### **Publikimi i pasqyrave financiare**

1. Shoqëritë e investimit do të publikojnë pasqyrat vjetore financiare të audituara dhe pasqyrat vjetore financiare të konsoliduara në faqen e saj të internetit, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asambleja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik në përputhje me rregullat për kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve të Raportimit Financiar.
2. Shoqëritë e investimit do të publikojnë pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare për periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor në faqen e tyre të internetit brenda afateve të përmendura në nenin 23 të kësaj rregulloreje.

## **KREU VI**

### **PASQYRAT FINANCIARE DHE SKEMA E LLOGARIVE KONTABËL TË FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE DHE SIPËRMARRJEVE ME PJESËMARRJE TË MBYLLUR DHE OSE ME INTERVALE**

## Neni 26

### **Pasqyrat financiare të fondeve të investimeve alternative, me pjesëmarrje të mbyllur dhe/ose me intervale**

1. Shoqëritë administruese të fondeve të investimeve alternative dhe/ose sipërmarrjeve me pjesëmarrje të mbyllur dhe/ose me intervale, për secilin fond nën administrim do të depozitojnë në Autoritet, brenda 15 ditëve nga data e vlerësimit:
  - a) Investimet dhe huamarrjen, tregjet ku investojnë dhe instrumentet në të cilat investojnë sipërmarrjet përfshirë kategoritë e instrumenteve në të cilat bëhet investimi;
  - b) Vlerën neto të aktiveve si dhe vlerën neto të aktiveve për kuotë sa herë që ato vlerësohen;
  - c) Vlerën e shitjeve ose shlyerjeve të pjesëmarrjeve;
  - d) Numrin e aksioneve ose kuotave në qarkullim dhe numrin e aksionarëve ose mbajtësve të kuotave, të ndarë sipas kategorive të klientëve (profesionistë dhe të kualifikuar dhe joprofesionistë).
  
2. Shoqëritë administruese të fondeve të investimeve alternative dhe/ose sipërmarrjeve me pjesëmarrje të mbyllur dhe ose me intervale, për secilin fond nën administrim do të dorëzojnë në Autoritet dhe publikojnë pasqyrat vjetore financiare të audituara në faqen e tyre të internetit, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asamblëja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik në përputhje me rregullat për kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve të Raportimit Financiar.
  
3. Afati i fundit për dorëzimin e pasqyrave financiare të audituara me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 prilli i vitit pasardhës.

## **KREU VII RAPORTE TË TJERA**

### Neni 27

#### **Raporte të mbikëqyrjes së likuiditetit për Sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike**

1. Raportet e mbikëqyrjes së likuiditetit për secilën nga sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbajnë:
  - a. Informacion mbi ndryshimet e supozimeve dhe rezultatet e provave të rezistencës (*stress testing*), si dhe planin e veprimit të miratuar nga këshilli i administrimit të shoqërisë administruese;
  - b. Llojin dhe tiparet e fondit të investimit, të dhëna mbi investitorët e fondeve të investimit sipas fashave të vlerës së investuar në fond;
  - c. Treguesit e portofolit, të tillë si vlera totale e asetëve, struktura e asetëve sipas periudhave të maturimit, likuiditeti, kthyeshmëria dhe modified duration;
  - d. Masën e ALCL, referencën e asetit, industrinë përkatëse të emetuesit, si dhe treguesit, sipas përcaktimeve të nenit 4 të rregullores “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike”.

2. Shoqëria administruese e fondit të investimit duhet të raportojë për secilin fond nën administrim informacionin mbi shlyerjet neto.
3. Shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive, në fund të çdo tremujori duhet të raportojë totalin e ALCL të investuara në treg aktiv në përputhje me kërkesat e shtojcës II të rregullores nr. 2, datë 27.01.2021 “Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët” dhe në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 4 të rregullores “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike”.
4. Përmbajtja dhe forma e raporteve të mbikëqyrjes së likuiditetit për fondet e investimit përcaktohen në Shtojcën 7, e cila është pjesë integrale e kësaj rregullore.

### **Neni 28**

#### **Afatet dhe forma për dorëzim të raporteve të mbikëqyrjes së likuiditetit për fondet e investimit**

1. Shoqëria administruese e fondit të investimit, për secilin fond që administron, duhet të raportojë çdo vit në Autoritet, brenda tremujorit të parë, dhe sa herë Autoriteti e kërkon ose ka ndryshime, raportet e përcaktuara në shkronjën a) të pikës 1 të nenit 27 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria administruese e fondit të investimit, për secilin fond që administron, së bashku me pasqyrat financiare të tyre, duhet të raportojë në Autoritet informacionin e përcaktuar në shkronjat b) c), dhe d), të pikës 1 si edhe në pikën 3 të nenit 27 të kësaj rregulloreje, në formë shkresore dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim, sipas afateve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 17 të kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria administruese e fondit të investimit për secilin fond nën administrim, duhet të raportojë çdo dy javë, brenda dy ditë pune pas përfundimit të periudhës dy javore për të cilën do të raportohet informacioni i përcaktuar në pikën 2, të nenit 27 të kësaj rregulloreje në formë shkresore dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim.
4. Në rast se vlera e rezervës së likuiditetit (*Liquidity buffer*) nuk mbulohet me asete sipas përcaktimeve të nenit 22, pika 3, të rregullores “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike”, shoqëria administruese pasi njofton menjëherë Autoritetin dhe depoziton menjëherë një plan masash, duhet të raportojë gjendjen ditore në fund të çdo dite, derisa niveli i likuiditetit të jetë brenda kufijve të përcaktuar dhe për aq kohë sa Autoriteti nuk ka vendosur ndryshe.
5. Autoriteti mund të kërkojë informacion shtesë ose raportim më të shpeshtë në lidhje me mbikëqyrjen e likuiditetit, nëse e gjykon të arsyeshme.

## **Neni 29**

### **Raport mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar**

1. Raporti mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar duhet të përfshijë të gjitha transaksionet me palë të lidhura dhe personat e lidhur, që janë kryer gjatë tremujorit.
2. Përmbajtja dhe forma e raportit mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar përcaktohen në Shtojcën 8, e cila është pjesë integrale e kësaj rregullore.

## **Neni 30**

### **Afatet dhe forma për dorëzim të raportit mbi transaksionet me palët e lidhura dhe/apo palët që i përkasin të njëjtit grup financiar**

Shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, për secilën sipërmarrje nën administrim, së bashku me pasqyrat financiare të tyre, duhet të raportojë në Autoritetin informacionin e përcaktuar në pikën 1 të nenit 29 të kësaj rregulloreje, në formë shkresore dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim, sipas afateve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 17 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 31**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

## **Neni 32**

### **Shfuqizimi**

Rregullorja nr. 127, datë 06.10.2011, e ndryshuar “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, shfuqizohet.

## **Neni 33**

### **Dispozita Kalimtare**

Për periudhat financiare deri në 31.12.2021, shoqëritë administruese përveç formave të raportimit të përmendura në këtë rregullore do të vazhdojnë të raportojnë dhe në formatin excel me email pranë departamentit përkatës të gjithë raportet e përfshira në shtojcat 1, 2, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

## Shtojca 1 – Raporte mbi aktivitetin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive

### 1. Raportet që shoqërojnë pasqyrat financiare të sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Periudha e raportimit:
Kodi i sipërmarrjes:
Emri i sipërmarrjes:
Emri i Shoqërisë së Administrimit:
1. Raporti mbi investimet - strukturën e aseteve financiare të fondit
2. Raporti mbi strukturën e detyrimeve financiare të fondit
3. Raporti mbi fitimet (humbjet) e realizuara
4. Raporti mbi fitimet (humbjet) e përealizuara
5. Raporti mbi transaksionet me palë të lidhura

<b>1. Raporti mbi investimet - strukturën e aseteve financiare të fondit, (në lekë)</b>
Periudha e raportimit:
Kodi i sipërmarrjes:
Emri sipërmarrjes:
Emri i Shoqërisë së Administrimit:

Pozicioni (aksione)	Numri i aksioneve	Kosto e blerjes për aksion	Kosto totale e blerjes	Vlera në datën e raportimit	Vlera për aksion	Përqindja e pronësisë tek emetuesi	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes
Aksione të zakonshme							
Aksione preferenciale							
Aksione në shoqëri investimi							
<b>Totali për aksione në shoqëri vendase</b>							
Aksione të zakonshme							
Aksione preferenciale (jashtë vendit)							
Aksione në shoqëri investimi (jashtë vendit)							
<b>Totali për aksione në shoqëri të huaja</b>							

<b>Pozicioni (obligacione)</b>	<b>Vlera nominale</b>	<b>Vlera e blerjes</b>	<b>Vlera në datën e raportimit</b>	<b>Përqindja e blerë e emetimit</b>	<b>Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes</b>
Obligacione të Qeverisë					
Obligacione Bashkiake					
Obligacione Shoqërishe					
<b>Totali për obligacionet e emetuesve vendas</b>					
Obligacione të Qeveritare					
Obligacione Shoqërishe					
<b>Totali për obligacionet e emetuesve të huaj</b>					

<b>Pozicioni (Letra të tjera me vlerë)</b>	<b>Vlera nominale</b>	<b>Vlera e blerjes</b>	<b>Vlera në datën e raportimit</b>	<b>Përqindja e blerë e emetimit</b>	<b>Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes</b>
Bono Thesari					
Emetime të Bankës Qendrore					
Dëftesa tregëtare					
Kuota në fonde					
Letra të tjera me vlerë					
<b>Totali i letrave të tjera me vlerë nga emetues vendas</b>					
Bono Thesari					
Emetime të Bankës Qendrore					
Dëftesa tregëtare					
Kuota në fonde					



Letra të tjera me vlerë					
<b>Totali i letrave të tjera me vlerë nga emetues te huaj</b>					

Pozicioni (depozita)	Maturiteti	Vlera në momentin e depozitimit	Vlera në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes
Depozita afatshkurtra				
Depozita afatgjata				
<b>Totali</b>				

Pozicioni (instrumente derivative)	Kosto në blerje	Vlera pozitive në datën e raportimit	Vlera negative në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes	Përqindja në detyrime
<b>Totali i Instrumenteve derivative</b>					

Pozicioni (Marrëveshjet e riblerjes - asete)	Kolaterali (ISIN)	Vlera Nominale	Vlera në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të fondit	Vlera e kolateralit
<b>Totali për marrëveshjet riblerjes</b>					

## 2. Raporti mbi strukturën e detyrimeve financiare të fondit (në lekë)

<b>Pozicioni (Marrëveshjet e Riblerjes - Detyrime)</b>	<b>Kolaterali (ISIN)</b>	<b>Vlera Nominale</b>	<b>Vlera në datën e raportimit</b>	<b>Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes</b>	<b>Vlera e Kolateralit</b>
<b>Totali për marrëveshjet e riblerjes</b>					

<b>Pozicioni (Detyrime të tjera)</b>	<b>Kosto në vendosje</b>	<b>Vlera në datën e raportimit</b>	<b>Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes</b>	<b>Përqindja në detyrimet e sipërmarrjes</b>
<b>Totali i detyrimeve të tjera</b>				

### 3. Raporti mbi Fitimet (Humbjet) e realizuara për periudhën nga ... deri në... (në lekë)

Data e shitjes	Instrumentet Financiare	Kategoria e aseteve financiare sipas IAS 39	Shuma apo Vlera nominale	Vlera kontabël/e drejte	Vlera e shitjes	Fitimi (Humbja e realizuar)
1	2	3	4	5	6	7=6-5
	Aksione të zakonshme					
	Aksione preferenciale					
	Aksione të shoqërive të investimit					
	Obligacione qeveritare					
	Obligacione bashkiake					
	Obligacione të shoqërive					
	Bono Thesari					
	Emetime të Bankës Qendrore					
	Dëftesa tregtare					
	Kuota në fonde investimi					
	Letra të tjera me vlerë					
	Letra me vlerë të strukturuar me vlerë të drejtë					
	Letra me vlerë të strukturuar me derivative të përfshira					
	Instrumente derivative					
	<b>Totali i fitimeve (humbjeve) të realizuara</b>					

<b>Ripërmbledhja sipas kategorive të aseteve financiare:</b>					
Fitime (humbje) të realizuara nga asete financiare me vlerë të drejtë					
Fitime (humbje) të realizuara nga asete të disponueshme për shitje					
Fitime (humbje) të realizuara nga asete financiare të mbajtura deri në maturim					

**4. Raporti mbi Fitimet (Humbjet) e porealizuara për periudhën nga ... deri në ... (në lekë)**

<b>Data e fundit e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet financiare</b>	<b>Kategoria e aseteve financiare sipas IAS 39</b>	<b>Vlera e blerjes</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>Rivlerësimi i aseteve të disponueshme për shitje</b>	<b>Rivlerësimi i rezervave për instrumentat e mbrojtjes (hedging)</b>	<b>Fitimi i porealizuar nga ndryshimi i çmimit, i njohur drejtpërdrejt përmes fitimit (humbjes)</b>	<b>Diferenca neto në kursin e këmbimit për investimet në letra me vlerë</b>	<b>Amortizimi I zbritjes (primit) për asetet me maturim fix</b>	<b>Dëmtimi (impairment i aseteve)</b>
	Aksione të Zakonshme									
	Aksione preferenciale									
	Aksione të shoqërive të investimit									
	Obligacione qeveritare									
	Obligacione bashkiake									
	Obligacione të shoqërive									
	Bono thesari									

Emetime të Bankës Qendrore									
Dëftesa tregtare									
Kuota në fonde investimi									
Letra të tjera me vlerë									
Letra me vlerë të strukturuar me vlerë të drejtë									
Letra me vlerë të strukturuar me derivative të përfshira									
Instrumente derivative									
<b>Totali I fitimit (humbjes së përealizuar)</b>									

<b>Ripërmbledhja sipas kategorive të aseteve financiare:</b>									
Fitimi (humbja) e perealizuar nga asete financiare me vlerë të drejtë									
Fitimi (humbja) e perealizuar nga asete të disponueshme për shitje									
Fitimi (humbja) e perealizuar nga asete financiare të mbajtura deri në maturim									

**5. Raporti i transaksioneve me palë të lidhura nga ... deri ... (në lekë)**

<b>Emri i palës së lidhur</b>	<b>Përshkrimi i transaksionit</b>	<b>Data e transaksionit</b>	<b>Shuma ose vlera nominale</b>	<b>Kosto e blerjes</b>	<b>Vlera e transaksionit</b>	<b>Fitimi (humbja) e realizuar</b>
Shoqëria e administrimit						
Sipërmarrje investimi e administruar nga shoqëria administruese						
Depozitare						
Firmë ligjore						
Konsulent taksash/ekspert kontabel						
Institucion krediti apo investues						



**6. Raport mbi pozicionet që rrjedhin nga lidhjet me palët e lidhura me sipërmarrjen e investimeve (në lekë)**

<b>Emri i palës së lidhur</b>	<b>Asete</b>	<b>Detyrime</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>Shpenzime</b>
Shoqëria e administrimit				
Sipërmarrje investimi e administruar nga shoqëria administruese				
Depozitare				
Firmë ligjore				
Konsulent taksash/ekspert Kontabël				
Institucion krediti apo investues				

